



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 qershor 2022
Nr. ref.:RK 2002/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI171/21

Parashtrues

Lutfi Shantiri

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së (mos) veprimit të
Gjykatës Themelore në Prizren, për të proceduar kërkesën për
revizion të parashtruesit të kërkesës, të 7 majit 2021 në Gjykatën
Supreme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Lutfi Shantiri, me vendbanim në Prizren (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston (mos) veprimin e Gjykatës Themelore në Prizren, për të proceduar kërkesën e tij për revizion në Gjykatën Supreme, ushtruar kundër Aktvendimit [Ac.nr411/2017] të Gjykatës së Apelit, të 2 shkurtit 2021.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së (mos) veprimit të Gjykatës Themelore në Prizren, për të proceduar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Supreme, me ç'rast i njëjti pretendon se me këtë mosveprim i janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 shtator 2021, kërkesa u dorëzua në postë, dhe e njëjta në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) u regjistrua më 20 shtator 2021.
6. Më 4 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 15 tetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës dhe bashkëngjitjen e dokumentacionit mbështetës.
8. Më 25 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës të plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës.
9. Më 25 mars 2022, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore në Prizren dhe Gjykata Supreme, në ndërlidhjeje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mohimin e ushtrimit të kërkesës për revizion në Gjykatën Supreme.
10. Më 1 prill 2022, Gjykata Supreme informon Gjykatën se në lidhje me kërkesën për revizion, të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, më 7 maj 2021, e njëjta më

13 gusht 2021, ka nxjerrë Aktvendimin Rev. nr. 343/2021 dhe se në tërësi shkresat e lëndës i janë kthyer Gjykatës së Apelit, më 1 shtator 2021. Aktit përcjellës Gjykata Supreme ia bashkëngjiti dhe një kopje të Aktvendimit Rev. nr. 343/2021, të 13 gushtit 2021.

11. Më 4 prill 2022, Gjykata Themelore në Prizren, sipas kërkesës së Gjykatës, të 25 marsit 2022, dorëzoi informata dhe dëshmi shtesë në Gjykatë përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke ia bashkëngjitur aktit përcjellës po ashtu edhe Aktvendimin Rev. nr. 343/2021 të Gjykatës Supreme, të 13 gushtit 2021.
12. Më 12 maj 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të deklarojë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve të rastit

13. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës për herë të dytë parashtron kërkesë në Gjykatë por jo për të njëjtën çështje civile. Ai më parë kishte parashtruar kërkesën KI19/20, për të cilën Gjykata, më 22 korrik 2020 nxori Aktvendimin për papranueshmëri, për shkak të mosshtrjes së mjeteve juridike.
14. Kërkesa e tanishme e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me çështje civile (pronësore), të iniciuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame, dega në Prizren, në lidhje me dorëzimin në posedim të paluajtshmërisë me nr. 07081-O, në sipërfaqe prej 316 metër katror, në vendin e quajtur "Altmejdani" e evidentuar në librat kadastralë me nr.997, në zonën kadastrale në Prizren, e cila duket të jetë shfrytëzuar nga parashtruesi i kërkesës.
15. Më 12 maj 2016, Këshilli i Bashkësisë Islame (paditësi), parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prizren, kundër parashtruesit të kërkesës (i padituri), nëpërmjet së cilës kërkoi dorëzimin në posedim të paluajtshmërisë së lartcekur, me pretendimin se e njëjta i takon ligjërisht kësaj bashkësie.
16. Më 19 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në kërkesëpadi, me propozimin që e njëjta të refuzohet, si e pabazuar, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të palës në këtë procedurë kontestimore.
17. Më 20 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Prizren, nëpërmjet Aktgjykimit C. nr. 501/2016: I. aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e Këshillit të Bashkësisë Islame; II. detyroi parashtruesin e kërkesës që ta lirojë paluajtshmërinë kontestuese; III. refuzoi kërkesëpadinë përkitazi me kompensimin e qerasë mujore prej 300 euro, në emër të shfrytëzimit të pabazë; dhe IV. detyroi parashtruesin e kërkesës që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguajë Këshillit të Bashkësisë Islame, shumën prej 15 euro.
18. Gjykata Themelore në Prizren, ndër të tjera në arsyetim, theksoi: "*Në anën tjetër pala e paditur nuk i ofroi gjykatës ndonjë provë të vlefshme materiale, e cila do të dëshmonte faktin se i padituri e ka të drejtën e pronësisë apo ka ndonjë bazë të vlefshme juridike në bazë të së cilës e ka fituar të drejtën e pronësisë në këtë paluajtshmëri kontestuese, apo të dëshmonte se ka ndonjë bazë të vlefshme*

juridike në bazë të së cilës i njëjti e mban në posedim dhe shfrytëzim ngastrën kontestuese. Gjykata vlerëson se bazuar në nenin 93 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS)' paditësi (pronari ka të drejtë të kërkojë kthimin në posedim të ngastrës kadastrale të përshkruar, si në pikën, II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga mbajtësi këtu i padituri, për faktin se ky i fundit këtë ngastër e posedon dhe e shfrytëzon pa ndonjë bazë të vlefshme juridike”.

19. Më 10 janar 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, të 20 dhjetorit 2016, për shkak të shkeljes së dispozitave të ligjit procedural, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Kundër aktgjykimit në fjalë ankesë kishte ushtruar edhe Këshilli i Bashkësisë Islame, në lidhje me pjesën refuzuese të dispozitivit që ndërlidhej me pagesën e qerasë për shkak të shfrytëzimi të paluajtshmërisë.
20. Më 2 shkurt 2021, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit të kontestuar, Ac. nr. 411/2017: I. refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, të 20 dhjetorit 2016; II. pranoi ankesën e Këshillit të Bashkësisë Islame dhe prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, përkitazi me pikën III të dispozitivit që i referohet pagesës së qerasë në emër të shfrytëzimit të paligjshëm duke e kthyer të njëjtin në rivendosje në këtë të fundit.
21. Gjykata e Apelit, ndër të tjera arsyetoi: *“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe drejtë i ka zbatuar edhe dispozitat e procedurës kontestimore por edhe të së drejtës materiale, si në paragrafin I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të goditur, që i referohet kërkesëpadisë së paditëses për lirimin dhe dorëzimin/kthimin në posedim të paluajtshmërisë lëndore, prandaj aktgjykimi i goditur nga i padituri - në këtë pjesë vërtetohet”. [...] Përfundim bën aktgjykimi i goditur në pjesën refuzuese të tij, që i referohet kërkesës së refuzuar të paditëses, me të drejtë ka kërkuar që të detyrohet i padituri, si përdorues pa bazë ligjore i paluajtshmërisë së paditëses, në dobi të vetë dhe i pasuruar pa bazë ligjore në dëm të saj, t'ia shpërblej pjesën e fitimit që ka pasur, minimumi në nivel të qirasë mujore prej 300,00, apo gjithsej shumë prej 4.800,00 €, duke filluar nga data 01.01.2015 deri në dorëzimin e paluajtshmërisë dhe pagimit përfundimtar, me kamatë vonese ligjore, i cili është i përfshirë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, prandaj i njëjti në këtë pjesë-prishej, sipas pretendimeve ankimore të paditëses”.*
22. Më 5 maj 2021, parashtruesi i kërkesës pohon se ka parashtruar kërkesë për revizion, nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prizren, në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 411/2017] të Gjykatës së Apelit, të 2 shkurtit 2021, në lidhje me pjesën refuzuese të ankesës, përkatësisht në lidhje me pikat I dhe II të dispozitivit. Sipas parashtruesit të kërkesës: *“Me rastin e dorëzimit të revizionit në Gjykatën Themelore në Prizren, nga zyrtarët ligjor të gjykatës është bërë një gabim dhe lënda me numër C. nr. 501/16, ka marrë numrin e ri C.nr.514/21. Disa herë kam shkuar të interesohem për revizionin të cilin e kam paraqitur por nuk po gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren”.*

23. Më 13 gusht 2021, Gjykata Supreme, nxori Aktvendimin Rev.343/2021, nëpërmjet të cilit u hodhë poshtë si e pasafatshme kërkesa për revizion e parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me (mos) veprimet e Gjykatës Themelore në Prizren i janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E drejta për Mjete Efektive] të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se më 5 maj 2021, kishte ushtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prizren. Megjithatë, ai pretendon se atij i është pamundësuar ushtrimi i këtij mjeti juridik, për shkak të një gabimi të bërë nga administrata e Gjykatës Themelore në Prizren, dhe për faktin se në databazën e kësaj të fundit nuk gjenden të dhëna për ushtrimin e revizionit, atij i është cenuar e drejta për “qasje në gjykatë dhe e drejta për mjet efektiv juridik, e cila parasheh që: *“Secili person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*.
26. Parashtruesi i kërkesës tutje argumenton: *“Për këtë gabim të administratës së gjykatës unë me datën 26.08.2021 i kam parashtruar kërkesë kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, me datën 27.08.2021 kam parashtruar kërkesë edhe në administratën e gjykatës (departamenti i përgjithshëm - divizioni civil) që të rregullohet ky gabim por që ende nuk kam marrë asnjë përgjigje nga ana e tyre. Po ashtu kam shkuar edhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, po as në këtë Gjykatë nuk gjendet revizioni i paraqitur nga ana ime, ata më treguan se nuk ka ardhur asnjë revizion në emrin tim në këtë Gjykatë”*.
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të konstatojë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij, për arsye se: *“Pas vendosjes me kërkesën e parashtruar, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, do të kemi mundësi, sepse do të obligohen gjykatat t'i respektojnë garancitë nga Kushtetuta - dispozitat e saj, për këtë jemi në pritje, sepse shkeljet e Kushtetutës, janë evidente dhe nëpërmjet evidentimit të tyre me aprovimin e kësaj kërkeje, do të eliminohen të gjitha shkeljet, të cilat kanë ndodhur”*.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

30. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtuesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtuesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

31. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës: i. legjitimohet si palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin Ac. nr. 2023/2020 e Gjykatës së Apelit, të 23 shkurtit 2021; iii. i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka parashtuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.

32. Më tej, Gjykata shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, që përcakton:
(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
33. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlenë për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43); dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
34. Gjykata vëren se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me shkeljen e të “drejtës për gjykatë” e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshmë: KEDNj), e cila pretendohet të ketë ardhur për shkak të të (mos) verimit të Gjykatës Themelore në Prizren, për të proceduar kërkesën për revizion, të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Supreme, ushtruar kundër Aktgjykimit [Ac.nr.411/2017] të Gjykatës së Apelit, të 2 shkurtit 2021.
35. Andaj, për të përcaktuar aplikueshmërinë e garancive të përcaktuara me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshmë: GjEDNj), përkitazi me të drejtën për qasje në gjykatë. Analiza vijuese do të bëhet në harmoni me kërkesat e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, normë të cilën Gjykata është e detyruar

ta aplikojë kur pretendohen shkelje të të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutë.

36. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton përmbajtjen e paragrafit 1 dhe 2, të nenit 31 të Kushtetutës, dhe të paragrafit 1, të nenit 6 të KEDNj-së, që përcaktojnë:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

[E Drejta për një Proces të Rregullt]

1. “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”

[...]

i. Parimet e përgjithshme përkitazi me të “drejtën për gjykatë”

37. E drejta për të pasur qasje në gjykatë për qëllime të nenit 6.1 të KEDNj-së është definuar në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* (shih rastin e GJEDNj-së, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975, paragrafët 28-36). Duke iu referuar parimit të sundimit të ligjit dhe shmangies së pushtetit arbitrar, GJEDNj-ja ka konstatuar se “e drejta për qasje në gjykatë” është aspekt thelbësor i garancive procedurale të mishëruara në nenin 6 të KEDNj-së. (Përkitazi me parimet e përgjithshme të së drejtës në gjykatë, shih gjithashtu Udhëzuesin e GJEDNj-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNj-së, e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesën II, E drejta në Gjykatë dhe gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNj-së, *Zubac kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Për më tepër, sipas GJEDNj-së, kjo e drejtë i siguron çdokujt të drejtën e adresimit të çështjes përkatëse që ndërlidhet me “të drejta dhe detyrime civile” para një gjykate (shih rastin e GJEDNj-së, *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 84 dhe referencat në të).
38. Gjykata në këtë kontekst thekson se e drejta në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, përcakton që ndërgjyqësit duhet

të kenë një mjet efektiv juridik që u mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 112).

39. Rrjedhimisht, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, çdokush ka të drejtë që të paraqesë “padi” lidhur me të “drejtat dhe detyrimet civile” përkatëse, tek një gjykatë. Neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së mishërojnë të “drejtën për gjykatë”, përkatësisht të “drejtën e qasjes në gjykatë”, e që nënkupton të drejtën për të filluar procedurat tek gjykatat në çështjet civile (shih rastin e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 36). Prandaj, çdokush që konsideron se ka pasur ndërhyrje të kundërligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe pretendon se i është kufizuar mundësia për të kontestuar një pretendim të tillë para një gjykate, mund t’i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur në të drejtën përkatëse për qasje në gjykatë.
40. Më specifikisht, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, së pari duhet të ekzistojë një “e drejtë civile” dhe së dyti, të ketë një “kontest” lidhur me ligjshmërinë e një ndërhyrje, që prek vetë ekzistencën apo fushëveprimin e “të drejtës civile” të mbrojtur. Definicioni i të dy këtyre koncepteve, duhet të jetë përmbajtësor dhe joformal (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së *Le Compte, Van Leuven and De Meyere kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 23 qershorit 1981, paragrafi 45; *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 23 tetorit 1990, paragrafi 66; *Gorou kundër Greqisë* (nr.2), Aktgjykim i 20 marsit 2009, paragrafi 29; dhe *Boulois kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 92). “Kontesti”, megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të jetë (i) i “vërtetë dhe serioz” (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 81; dhe *Cipolletta kundër Italisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2018, paragrafi 31); dhe, (ii) rezultatet e procedurave para gjykatave duhet të jenë “vendimtare” për të drejtën civile në fjalë (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Ulyanov kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 5 tetorit 2010). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, “lidhjet e paqëndrueshme” ose “pasojat e largëta” në mes të drejtës civile në fjalë dhe rezultatit të këtyre procedurave, nuk janë të mjaftueshme për të qenë në fushëveprimin e nenit 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, *Lovrić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 4 prillit 2017, paragrafi 51 dhe *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 71 dhe referencat në të).
41. Në raste të tilla, kur është konstatuar të ketë një “të drejtë civile” dhe një “kontest”, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së i garantojnë individit të drejtën “që ajo çështje të zgjidhet nga një tribunal” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Z dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 92). Refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e palëve lidhur me pajtueshmërinë e një procedure me garancitë procedurale themelore të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, kufizon qasjen e tyre në gjykatë (shih rastin e GJEDNJ-së *Al Dulimi dhe Montana Management Inc kundër Zvicrës*, Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).

42. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, KEDNJ nuk synon të garantojë të drejta që janë “teorike dhe të rreme”, por të drejta që janë “praktike dhe efektive” (shih, për më tepër rreth të drejtave “praktike dhe efektive”, Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018 për nenin 6 të KEDNJ-së, E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, Pjesa II. E Drejta në Gjykatë, A. E Drejta dhe Qasja në Gjykatë, 1. Një e drejtë praktike dhe efektive; dhe rastet e GJEDNJ-së *Kutić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 25 dhe referencat e cituara aty; dhe *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të).
43. Prandaj, në kuptim të këtyre të drejtave, neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, garantojnë jo vetëm të drejtën për të filluar procedura, por edhe të drejtën për të marrë një zgjidhje të “kontestit” përkatës nga një gjykatë e themeluar me ligj (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Kutić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 25-32; *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 86 dhe referencat në të; *Acimović kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafi 41; dhe *Beneficio Cappella Paolini kundër San Marinos*, Aktgjykim i 13 korrikut 2004, paragrafi 29).
44. Parimet e lartpërmendura megjithatë nuk nënkuptojnë që e drejta për gjykatë dhe e drejta e qasjes në gjykatë janë të drejta absolute. Ato mund të jenë subjekt i kufizimeve, të cilat janë qartë të përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së (shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 31 dhjetorit 2018, për nenin 6 të KEDNJ-së e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Aspekti Civil, dhe specifikisht përkitazi me kufizimet në të drejtën në gjykatë, Pjesën II. E drejta në Gjykatë, A. E drejta dhe në qasja në Gjykatë. 2. Kufizimet). Megjithatë, këto kufizime nuk mund të shkojnë deri në atë masë sa të kufizojnë qasjen e individit ashtu që të cenohet vetë thelbi i të drejtës (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Baka kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; dhe *Famullia Greko-katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 89 dhe referencat në të). Kurdo që qasja në gjykatë kufizohet nga ligji ose praktika përkatëse gjyqësore, Gjykata shqyrton nëse kufizimi prek thelbin e të drejtës dhe, në veçanti, nëse ky kufizim ka ndjekur një “qëllim legjitim” dhe nëse ekziston “një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 28 majit 1985, paragrafi 57; *Famullia Greko-katolike Lupeni kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 89; *Naït-Liman kundër Zvicrës*, cituar më lart, paragrafi 115; *Fayed kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 21 shtatorit 1990, paragrafi 65; dhe *Marković dhe të tjerët kundër Italisë*, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 99).

ii. Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

45. Gjykata rikujton edhe një herë se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ndërlidhet me mosadministrimin (procedimin) e kërkesës për revizion nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren, në Gjykatën Supreme, ushtruar si mjet juridik, kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 411/2017] të Gjykatës së Apelit, të 2 shkurtit 2021.

46. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës, pretendon se: *“Për këtë gabim të administratës së gjykatës unë me datën 26.08.2021 i kam parashtruar kërkesë kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, me datën 27.08.2021 kam parashtruar kërkesë edhe në administratën e gjykatës (departamenti i përgjithshëm - divizioni civil) që të rregullohet ky gabim por që ende nuk kam marrë asnjë përgjigje nga ana e tyre. Po ashtu kam shkuar edhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, po as në këtë Gjykatë nuk gjendet revizioni i paraqitur nga ana ime, ata me treguan se nuk ka ardhur asnjë revizion në emrin tim në këtë Gjykatë”*.
47. Gjykata, duke iu referuar pretendimeve të sipërcekura, rikujton se ajo më 25 mars 2022, i është drejtuar me kërkesa të veçanta Gjykatës Themelore në Prizren dhe Gjykatës Supreme, për të kuptuar se çfarë kishte ndodhur me kërkesën për revizion të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Prizren, më 5 maj 2021. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme, më 1 prill 2022, informoi Gjykatën se përkritazi me revizionin e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 411/2017] të Gjykatës së Apelit, të 2 shkurtit 2021, e njëjta më 13 gusht 2021, kishte nxjerrë Aktvendimin Rev.nr.343/2021, nëpërmjet të cilit është hedhur poshtë revizioni i parashtruesit të kërkesës, si i pasafatshëm.
48. Në ndërkohë, më 4 prill 2022, Gjykata Themelore në Prizren, bazuar në kërkesën e Gjykatës, të 25 marsit 2022, dhe përkritazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se kërkesa e tij për revizion, ishte regjistruar gabimisht nga administrata e Gjykatës Themelore në Prizren, si lëndë e re civile, sqaron, si në vijim: *“Pas pranimit të aktgjykimit, pala e paditëse Këshilli i Bashkësisë Islame, me seli në Prizren, ka parashtruar ankesë dhe lënda është dërguar në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e cila me Aktgjykimin numër Ac.nr.411/17, të datës 02.02.2021, e ka refuzuar ankesën e të paditurit Lutfi Shantiri, ku në pikën I dhe II të dispozitivit e ka VERTETUAR, aktgjykimin e shkallës së parë C.nr.501/16, të datës 20.12.2016, ndërsa në pikën III të dispozitivit e ka pranuar ankesën e paditësit, duke e PRISHUR, aktgjykimin e shkallës së parë C.nr.501/16, të datës 20.12.2016, në paragrafin III të dispozitivit dhe lënda ka marrë numër të ri C.nr.514/2021”*.
49. Ndërsa, sa i përket procedimit të kërkesës për revizion në Gjykatën Supreme, Gjykata Themelore në Prizren, sqaron: *“Në shkresat e lëndës shihet që i padituri Lutfi Shantiri, me datë 11.05.2021, ka paraqitur revizion, e cila është dërguar në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev.343/2, të datës 13.08.2021, e ka hedhur si të paafatshme revizionin e të paditurit Lutfi Shantiri, nga Prizreni, i paraqitur kundër aktgjykimit të Apelit të Kosovës, Ac.nr. 411/2021, të datës 02.02.2021. Dorëzimi i parashtrësve: Ne këtë akt ju dërgojmë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.343/2021, të datës 13.08.2021, si dhe dëshminë e pranimit të aktvendimit Rev.nr.343/21, të datës 13.08.2021, në shkresat e lëndës vërtetohet se Lutfi Shantiri e ka pranuar me datë 20.09.2021”*.
50. Gjykata nga shkresat e lëndës vëren se, Gjykata Supreme, hedhjen poshtë si të pasafatshëm të revizionit, e kishte arsyetuar si në vijim: *“Në nenin 211.1 të LPK-së, parashihet që kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën u është*

dorëzuar aktgjykimi. Nga shkresat e lëndës, përkatësisht nga fletë dorëzimi për dorëzim personal të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë të paditurit Lutfi Shantiri, rezulton se i padituri Lutfi këtë aktgjykim e ka pranuar më datë 06.04.2021, dhe duke pasur parasysh që dita e pranimit të aktgjykimit nuk llogaritet në afatin për paraqitjen e revizionit, rezulton se i padituri përmes postës me kuvertë rekomande me datë 07.05.2021 ka paraqitur revizionin kundër aktgjykimit të njëjtë të gjykatës së shkallës së dytë. Kjo datë, data e dorëzimit në postë, 07.05.2021 ka qenë ditë e enjte, ditë pune, që është dita e tridhjetë e një, kur është paraqitur revizioni, ndërsa në kuptim të dispozitës së lartpërmendur ligjore afati tridhjetë ditor për paraqitje të revizionit ka përfunduar me datën 6 maj, ditë e enjte, nuk ka qenë asnjë lloj feste zyrtare, kështu që me paraqitjen e tij të nesërmen, ditën e premte me datë 07.05.2021, rezulton se revizioni është paraqitur një ditë më vonë, pas kalimit të afatit ligjor, prej 30 ditësh për paraqitjen e tij”.

51. Nga sa më lart, Gjykata vëren se më 10 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar kërkesën në postë, e cila në Gjykatë kishte arritur dhe ishte regjistruar më 20 shtator 2021. Në lidhje me regjistrimin e kërkesës, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar nga Gjykata më 15 tetor 2021, nga i cili mes tjerash kishte kërkuar plotësimin e formularit të kërkesës dhe bashkëngjitjen e dokumentacionit mbështetës. Parashtruesi i kërkesës, më 25 tetor 2021, e dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës, të cilit ia kishte bashkëngjitur dokumentacionin mbështetës.
52. Megjithatë, Gjykata nuk ishte informuar nga parashtruesi i kërkesës për faktin se Gjykata Supreme, përkitazi me kërkesën për revizion, e kishte nxjerrë Aktvendimin [Rev. nr. 343/21], me të cilin revizioni ishte hedhur poshtë si i pasafatshëm, më 13 shtator 2021. Sipas, informatave të dorëzuara nga Gjykata Themelore në Prizren, Gjykata vëren se Aktvendimi në fjalë i është dorëzuar personalisht parashtruesit të kërkesës, më 20 shtator 2021, që nënkupton se parashtruesi i kërkesës kishte dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës Supreme, para 25 tetorit 2021, datë në të cilën ai kishte dorëzuar formularin e plotësuar të kërkesës së bashku me dokumentacionin mbështetës.
53. Gjykata, duke pasur parasysh shkresat e lëndës dhe të gjitha shtjellimet e mësipërme, vjen në përfundim se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për “qasje në gjykatë” nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren, janë të pambështetura në prova materiale, sepse shkresat e lëndës konfirmojnë të kundërtën e pretendimeve të tij, se atij i është pamundësuar ushtrimi i kësaj të drejte në mënyrë efektive në Gjykatën Supreme, për shkak të mosprocedimit të kërkesës për revizion nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren. Për më tepër, Gjykata konkludon se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar po ashtu në mënyrë efektive ushtrimi i mjetit juridik (revizioni), kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 2 shkurtit 2021.

Përfundim

54. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, përkitazi me të drejtën për “qasje në gjykatë”, i përkasin kategorisë së tretë (iii),

nënkategorisë (b), të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese duhet të shpallen qartazi të pabazuara.

55. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 12 maj 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhalij-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani